

# TË KAPEMI FORT MBAS MENHEXHIT SELEFIJ

autor Shejkh  
Rabij' Ibn Hadi e - Medkhalij

shtojcë nga Imam  
'Abdul-'Aziz Ibn Baz

النَّمْسُكَ بِالْمَنْجِ السُّلْفِي

ربيع بن هارون المرخمي



Kurani dhe Suneti me kuptimin e Selefëve të këtij Umri

Selefi.org

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

## Parathënie

أحمد لله والصلاة والسلام  
على رسول الله  
وبعد

Kjo është një ligjëratë e mbajtur nga dijetari i nderuar Rabi' Ibën Hadi el-Medkhalij - *hafidhahullah* -, në Xhaminë e Shejkh 'Abdul-'Aziz Ibën Bazit në Ta'if, më 3 Muharrem të vitit 1413 Hixhrij. Autori, i cili është njëkohësisht një nga nxënësat më të afërt të Shejkh Ibën Bazit - Allahu pastë mëshirë për të - diskuton rëndësinë dhe domosdoshmërinë e ndjekjes së metodologjisë së Selefëve. Njëkohësisht, ai paralajmëron kundër shkaqeve dhe faktorëve që kanë shkaktuar ndarje e përçarje midis Muslimanëve në kohën e sotme.

Në fund të ligjëratës, Shejkh Ibën Bazi - Allahu pastë mëshirë për të - pasi vlerëson fjalët e dijetarit Rabi' el-Medkhalij, ai bën komentet e tij për temën e trajtuar duke rikthësuar fjalët e parafolësit dhe jep disa këshilla të vyera.

Lexuesi do të gjejë tek kjo broshurë një realitet krejt ndryshe nga ç'ka dëgjuar deri më sot. Ai do të shohë se rruga e dijetarit Rabi' el-Medkhalij është në harmoni me rrugën e dijetarit të madh 'Abdul-'Aziz Ibën Baz, ndonëse shpifjet dhe gënjeshttrat e të devijuarve e kanë mjegulluar këtë realitet.

Suksesi vjen vetëm prej Allahut.

Përkthyesi: Alban Malaj

'Auali, Mekkeh  
E Xhuma, 2 Prill 2010/17 Rabi' eth-Thanij 1431 Hixhrij



## Hyrje:

Vërtet, të gjitha lavdërimet janë për Allahun. Ne e lavdërojnë Atë dhe kërkojmë ndihmën dhe faljen e Tij. Kërkojmë strehim tek Allahu nga të këqijat e veteve dhe veprave tona. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush që ta humbasë, dhe atë që e humb Allahu nuk ka kush që ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut të vetëm e i pashokë dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ ۖ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿١٢﴾

“O ju që besoni. Frikësojuni Allahut ashtu sikurse i duhet pasë frikë Atij dhe mos vdisni vetëm se duke qenë Muslimanë.”<sup>1</sup>

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ ۖ وَاللَّهُ كَانَ

عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ﴿١٠١﴾

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me Emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjellta dhe ruani lidhjet farefisnore. Vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Aali-Imran, 102.

<sup>2</sup> En-Nisaa`, 1.

يَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ﴿٧٠﴾ يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ

لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۗ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴿٧١﴾

“O ju që besoni. Plotësoni detyrimin ndaj Allahut dhe kijeni frikë Atë dhe flisni (gjithnjë) të vërtetën. Ai do t’ju drejtojë tek veprat e mira e të drejta dhe do t’ua falë gjynahet. Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, me të vërtetë që ka arritur fitoren më të madhe.”<sup>3</sup>

E më pas: Vërtet fjala më e mirë është Fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është Udhëzimi i Muhamedit - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* - dhe punët më të këqia janë ato të shpikurat. Çdo punë e shpikur është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje të shpie në Zjarr.

Më tej:

Vërtet, ky është një rast i shkëlqyer për ne që kemi mundësinë të takohemi me Shejkhun tonë dhe nxënësit e tij, për të cilët shpresojmë se Allahu - *Tebarake ue Te’ala* - do t’i bekojë dhe do t’i bëjë ata flamur-mbajtës të Sunetit, Sunetit të Muhamedit - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* -, sipas rrugës së Selefëve të nderuar, në përhapjen e Teuhidit të Allahut, në përhapjen e Sunetit të Dërguarit të Allahut - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* -, si dhe në përpjekjet për të shporrur shpikjet në Fe dhe të gjitha supersticionet, kundër të cilave na ka paralajmëruar i Dërguari i Allahut - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* -.

Vërtet, Allahu - *Tebarake ue Te’ala* - e dërgoi Muhamedin si mëshirë për të gjitha botët, për t’i nxjerrë njerëzit nga errësira dhe për t’i sjellë ata në dritë. Dhe ai e përcolli këtë mesazh dhe e përmbushi amanetin që iu ngarkua. Kështu, Allahu i nxorri njerëzit nga errësira dhe i solli ata në dritë. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij. Allahu na ka urdhëruar që të besojmë të Dërguarin e Tij, t’i bindemi dhe ta ndjekim atë, lavdërimet dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të. Dhe me të vërtetë kënaqësia jonë në këtë botë dhe në botën tjetër varet nga njohja jonë.

---

<sup>3</sup> El-Ahzab, 70-71.

Për këtë arsye, shihet në mjaft ajete të Kur'anit se Allahu - *Tebarake ue Te'ala* - na nxit që t'i bindemi dhe ta ndjekim këtë të Dërguar dhe na tërheq vëmendjen në shumë ajete kundër mosbindjes dhe kundërshtimit të Pejgamberit, si dhe i ka premtuar atij që e kundërshton të Dërguarin Zjarrin, Allahu na ruajt prej tij. Prandaj ne tërheqim vëmendjen duke paralajmëruar fuqishëm për të mos rënë në kundërshtim dhe në konflikt me udhëzimin e këtij të Dërguari fisnik - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - në të gjitha çështjet e jetës. Ju duhet ta bëni realitet mu para syve tuaj thënien e Allahut:

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا ۗ وَاذْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنْتُمْ أَعْدَاءً  
فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا

“Dhe kapuni fort të gjithë ju pas Litarit të Allahut dhe mos u ndani. Dhe kujtoni Mirësinë e Allahut për ju sepse kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja dhe me Mirësinë e Tij ju u bëtë vëllezër.”<sup>4</sup>

Çështja e këtij Umeti nuk mund të vendoset në drejtimin e duhur apo të jetë e paluhatur përveç se duke iu bindur këtij të Dërguari dhe duke ndjekur e pasuar udhëzimin e tij me vërtetësi dhe sinqeritet, duke u kapur fort mbas asaj me të cilën erdhi ai - që është Litari i Allahut - pra Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* -.

Umeti nuk mund të qëndrojë drejt përveç se duke vepruar kështu. Prandaj, ne të gjithë duhet të kapemi fort pas Litarit të Allahut - *Teabarake ue Te'ala* -, individë dhe shoqëri, njerëzit e thjeshtë dhe udhëheqësit e pushtetarët. Është obligim që të kapemi fort pas Litarit të Allahut - *Teabarake ue Te'ala* -, pasi Zoti ynë nuk do të kënaqet me asgjë tjetër përveç se që të kapemi fort pas Litarit të Tij të kapemi fort me dhëmballë mbas Udhëzimit të Tij dhe Udhëzimit të të Dërguarit të Tij - *'alejhi salatu ues-selam* - dhe udhëzimit të Prijësave të Udhëzuar, ashtu siç na ka porositur i Dërguari - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* -, në përputhje me ajetet që përmendëm më parë. Me të vërtetë, kjo është një çështje dhe një përgjegjësi e jashtëzakonshme dhe ne po e shohim sot këtë Umet që është ndarë dhe përçarë në shumë fraksione. E si mund të jemi ne të kënaqur me këtë gjendje?!

---

<sup>4</sup> Aali-Imran, 103.

Vërtet, ky Umet po ndjek epshet, Allahu na ruajt nga kjo gjë. Sikur të gjykohemi nga Allahu dhe i Dërguari i Tij në çështjet ku kemi mospajtim, gjendja e tanishme nuk ka për të vazhduar më. Mirëpo fakti që ne po vazhdojmë në këtë rrugë është argument që tregon se shumë njerëz ndjekin epshet e tyre, janë të fiksuar mbas udhëheqësve të tyre dhe nuk iu nënshtrihen udhëzimeve të Allahut - *Tebarake ue Te'ala* -.

فَإِنْ تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ

ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا

“...dhe nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, atëherë drejtojeni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kijametit. Kjo është më e mirë dhe më e përshtatshme për përcaktimin e fundit.”<sup>5</sup>

Duhet patjetër që gjykimi të kthehet tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Në këtë mënyrë do të marrin fund mospajtimet, do të largohet kjo ndarje dhe do të shuhet këto epshe. Dhe nëse nuk jemi në këtë nivel, atëherë përpara do të kemi vetëm humbje, përpara do të kemi vetëm devijim, rrënim dhe shkatërrim në dunja e në ahiret.

Kurse ne, pasha Allahun, ne jemi të qetë nën hijen e davetit Selefij. Ai davet Selefij, flamurin e të cilit e ngriti lart Imami dhe Muxhedidi Muhamed Ibën ‘Abdul-Uehhab sipas rrugës së Sahabëve të të Dërguarit të Allahut - *‘alejhis-salatu ues-selam* -, Prijësave të tij të Udhëzuar dhe Imamëve të shquar të brezave më të mirë, duke ndjekur me përpikmëri rrugën dhe modelin e tyre në ibadet, në akijde, në qeverisje dhe në çdo çështje që ka të bëjë me jetën e Muslimanëve.

Kështu, Allahu i dha fund këtyre pavërtetësive, këtyre mashtrimeve, këtyre devijimeve dhe këtyre lajthitjeve, si dhe gjynaheve të tilla si lënia e namazit, vrasja dhe marrja e pasurisë në mënyrë të jashtëligjshme; Allahu u dha fund këtyre pavërtetësive, marrëzive e devijimeve nëpërmjet këtij daveti të bekuar.

---

<sup>5</sup> En-Nisaa`, 59.

Dhe Allahu me mirësinë e këtij daveti ngriti universitete që ndriçuan botën, themelet e të cilave janë në menhexhin e vërtetë të Allahut. Kështu pra, kur përmendim menhexhin Selefi apo davetin Selefi, ne kemi për qëllim davetin e bekuar që ka bërë i Dërguari i Allahut dhe që e pasuan Sahabët e nderuar, pastaj Imamët e udhëzimit të këtij Umeti dhe ata që i pasuan më mbas, si Ahmed Ibën Hanbel, Ibën Tejmije dhe Muhamed Ibën ‘Abdul-Uehhab, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata. Kjo Fe është e përsosur. Ajo nuk ka nevojë për mendime apo koncepte që vijnë nga çfarëdo drejtimi apo nga çfarëdo partie apo grupacioni. Pra, Feja është e përsosur ashtu siç gjendet në Librin e Allahut dhe në Sunetin e të Dërguari të Allahut dhe në botëkuptimin e pararendësve të nderuar, ata të cilët e kuptuan Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut me një kuptim të vërtetë e të saktë, si në aspektet e Akijdes ashtu edhe në Ibadet.

Prandaj mbahuni fort tek ky Menhexhi i Selefëve për të cilin sapa folëm, sepse nuk ka dyshim që ai është e vërteta dhe është Menhexhi i Grupit të Ndihtuar e Ngadhënjimtar (*Tajfetul-Mensurah*), për të cilin na ka lajmëruar i Dërguari i Allahut - ‘*alejhi salatu ue selam* -, se me të vërtetë ai Grup është në të vërtetën dhe nuk do të pushojë së qëndruari tek kjo e vërtetë, që është Menhexhi i Grupit të Shpëtuar (*Firkatun-Naaxhijeh*). Dhe ai është Grupi i Ndihtuar e Ngadhënjimtar për të cilën na ka treguar i Dërguari i Allahut rreth ndarjes së Umetit.

Dhe Allahu e ka vërtetuar këtë lajm. Umeti tashmë është ndarë dhe përçarë, por vazhdon të mbetet ky Grup, Njerëzit e Hadithit (*Ehlul-Hadijth*), fakt të cilin e kanë pranuar edhe Njerëzit e Bidatit (*Ehlul-Bid’ah*), pasi që është dëshmuar nga njerëzit e Sunetit (*Ehlus-Sunneh*) se me të vërtetë ata janë Njerëzit e Hakut (*Ehlul-Hak*), janë Grupi i Ndihtuar e Ngadhënjimtar (*Tajfetul-Mensurah*) dhe janë Grupi i Shpëtuar (*Firkatun-Naaxhijeh*), rrugën e të cilëve e pasuan Ibn Tejmija dhe Ibën ‘Abdul-Uehhabi, Allahu qoftë i kënaqur me ata.

Ka qenë mirësia e Allahut për ne që kemi qëndruar të qetë nën hijen e kësaj thirrjeje të bekuar, që jemi ndriçuar me dritën e saj jo vetëm në këtë vend por në të gjithë botën. Përveç kësaj, sikur të mos ishte për pengesat që kanë vendosur para këtij daveti armiqtë e Allahut dhe njerëzit e bidatit dhe devijimit, ju do ta kishin parë Botën Islame të ndriçuar me dritën e këtij daveti të bekuar, mbasi që ai filloi të përhapet dhe kalojë në çdo vend të botës.



Mirëpo njerëzit e bidatit dhe njerëzit e kufrit thurën plane e komplete për ta ndalur shtrirjen e mëtejshme të këtij daveti, këtë valë të fuqishme. Ata bënë çmos që ta ndalin përhapjen e këtij daveti.

Prandaj ju e keni detyrë që të jeni të ndërgjegjshëm dhe t'i kuptoni këto mjete që përdorin ata dhe këto kurthe që kanë thurur kundër këtij daveti, pasi ata nuk mund të flenë gjumë ndërkohë që drita e këtij daveti shtrihet dhe përhapet akoma më tej. Njerëzit e Bidatit dhe Devijimit nuk mund të flenë gjumë, qofshin bidatet dhe devijimet e tyre kufër, hizbije, sufizëm, rrafidizëm apo çfarëdolloj devijimi qoftë. Dhe vërtet ata nuk mund të mbyllin sytë dhe nuk mund të jenë kurrë të qetë kur ky davet Islamik Selefij i vërtetë përhapet në tokë, prandaj ata thurën komplete kundër tij. Kështu që, kini mendjen o ju të rinj dhe kapuni fort të gjithë së bashku pas Litarit të Allahut ashtu siç ju ka urdhëruar Allahu dhe ruajuni nga përçarja, këputini rrënjët e kësaj përçarjeje, këputini plotësisht rrënjët dhe shkaqet themelore që çojnë në të, pavarësisht nëse shkak ka qenë epshi apo fanatizmi (*te'asub*) apo çfarëdo qoftë tjetër.

Ky është obligim mbi ju o vëllezërit e mi. Dhe me të vërtetë po shohim se shumë nga të rinjtë nuk përmbahen dot nga gënjeshtria dhe mashtrimi dhe as nga goditja dhe shkelja e nderit të thirrësave Selefijinë, njerëzve të Hakut, të cilët nuk janë thirrësa të hizbijes apo të së pavërtetës. Ata po sulmojnë nderin e këtyre thirrësave dhe po e prishin imazhin e tyre duke përdorur gënjeshtria dhe duke shpifur kundër tyre.

Prandaj ju e keni detyrë që të thoni të vërtetën, sepse vërtetësia të shpie vetëm në mirësi dhe mirësia të shpie vetëm në Xhenet. Dhe robi vazhdon të thotë të vërtetën dhe shkon mbas të vërtetës derisa ai të shkruhet tek Allahu si një prej atyre që thonë të vërtetën (*Siddijk*). Poashtu, robi vazhdon të gënjejë e shkon mbas gënjeshtreve derisa të shkruhet tek Allahu si një prej atyre që janë gënjeshtarë (*kedhab*).

Ka njerëz të cilët merren me gënjeshtria, andaj ne s'jemi të sigurtë nëse ata janë shkruajtur tek Allahu si gënjeshtarë. Allahu na ruajt nga kjo gjë! E çfarë janë duke pritur ata? I Dërguari i nderuar na ka paralajmëruar o vëllezër kundër fanatizmit mbas fisit apo grupacionit. Një njeri thirri, "O ju Ensarë!". Kurse tjetri thirri, "O ju Muhaxhirunë!". 'Ensar' është një emërtim fisnik që ka ardhur në Librin e Allahut dhe në Sunetin e të

Dërguarit, ashtu sikurse termi ‘Muhaxhir’. Mirëpo kur këto dy cilësime u përdorën për të thirrur drejt epsheve dhe të pavërtetës, i Dërguari i Allahut tha:

ادعوى الجاهلية وأنا بين أظهركم، دعوها فإنها منتنه.

*“Po bëhen thirrje të Xhahilijetit ndërkohë që unë ende jam mes jush??? Lërimi ato sepse janë me të vërtetë të fëlliqta.”*

Dhe sot kjo fëlliqësi buron nga fanatizmi (*et-te’asub*) që është i pranishëm në fushën (e davetit). Në vend që të rinjtë të lidhen mbas këtij Menhexhi të vërtetë, ata janë kapluar nga epshet dhe janë kapluar nga përçarja, Allahu na ruajt.

Kjo është një mirësi nga Allahu *Tebarake ue Te’ala*. A na lejohet që t’i kthejmë shpinën asaj? Vërtet, ky vend u nda në pjesë të ndryshme dhe populli i tij u nda poashtu në sekte, grupe e fise të ndryshme. Madje edhe vetë fiset ishin ndarë në grupe e fraksione që sulmonin dhe plaçkisnin njëri-tjetrin. Por Allahu e bashkoi këtë gadishull nëpërmjet këtij daveti të pastër e të bekuar, daveti i Teuhidit, Teuhid në Akijde, Teuhid në Fenë e Allahut dhe unifikimin e Umetit në një fjalë të përbashkët dhe në një menhexh të vetëm. Kjo është mirësi nga Allahu - *Tebarake ue Te’ala* -!

Por kaluan brezat dhe gadishulli Arabik filloi të humbiste në injorancë, devijim, bidate, supersticione, shirkijate, vrasje, përdhunime dhe plaçkitje.

Pastaj Allahu e bashkoi sërish gadishullin Arabik nëpërmjet këtij daveti të pastër e të bekuar.

Mirëpo njerëzit e të pavërtetës nuk ndihen mirë para këtij daveti. Ata duan veçse të keqen për këtë davet dhe duan që ai të shpërbëhet e të bëhet copë e çikë, ngase Njerëzit e Bidatit kanë frikë nga Menhexhi Selefij ngase ai pasqyron të vërtetën. Madje edhe Kristianët me Çifutët nuk i frikësohen gjëje tjetër përpos këtij Islami të cilin ata e quajnë “Islami Vehabij”.

Unë e kam ndjekur dhe e kam vëzhguar me kujdes përhapjen graduale të këtij daveti Selefij në botë. Populli i Algjerisë drejtoheshin tek Shejkh Ibën Bazi, tek Shejkh Shejkh Ibën Utnejmini dhe tek Shejkhul-Albani,

Imamët e menhexhit Selefij. Populli i Algjerisë ishin gati ta vinin në praktikë këtë menhexh, mirëpo armiqtë e Allahut thurën komplete që t'i devijonin këta të rinj në drejtime të tjera dhe i çuan ata shumë larg menhexhit të vërtetë të Allahut.

Në këtë vend u hapën universitete. Shiko çfarë kanë arritur tani: e gjithë kjo është shkak i kompleteve të njerëzve të bidatit dhe njerëzve të devijimit, mbas të cilëve qëndrojnë armiqtë e Allahut. Kjo për shkak se ata ia kanë frikën këtij Islami, prandaj ata thurën komplete për të luftuar Selefizmin në Pakistan dhe Afganistan. Armiqtë e Allahut thurën komplete dhe luftuan kundër tij. Ata duan ta luftojnë Selefizmin në këtë vend dhe duan ta ç'rrenjosin atë.

Nuk ka shpëtim për këtë Umet dhe nuk ka shpëtim për këta njerëz dhe as për këtë gadishull (Arabik) përveç se duke u kapur fort të gjithë bashkë pas Litarit të Allahut, duke hedhur mbas shpine ndarjen, duke ç'rrenjosur të gjithë shkaqet që të shpien në ndarje dhe duke i braktisur këto ideologji dhe thirrje të kota që janë përhapur gjithandej.

Pasha Allahun, ne e dimë se Arabët gjatë kohës para ardhjes së Islamit dhe pas hyrjes së tyre në Islam e kishin për turp që të gënjenin. Kurse sot, shumë njerëz nuk kanë turp që të gënjejë apo të shpifin apo të ndjekin verbërisht dhe fanatikisht grupacione të ndryshme. Dhe në të vërtetë Islami ka paralajmëruar ashpër kundër këtyre gjërave! Siç ka thënë i Dërguari i Allahut - *'alejhis-salatu ues-selam* -:

من خرج عن الطاعة وفارق الجماعة مات ميتة جاهلية.

*“Kush heq dorë nga bindja (ndaj prijësit të Muslimanëve) dhe ndahet nga Xhemati, ai vdes me një vdekje të Xhahilijetit.”*

[Kurse në një transmetim tjetër qëndron]:

من خرج من الطاعة وفارق الجماعة فمات مات ميتة جاهلية، ومن قاتل تحت راية عمية أو عمية، - يجوز اللفظان - يدعو إلى عصبية أو يدعو إلى عصبية ويغضب لعصبه وينصر عصبه فقتل فقتلته جاهلية، ومن خرج على أمي يضرب برها وفاجرها فقد برئ مني وبرئت منه.

“Kush heq dorë nga bindja (ndaj prijësit të Muslimanëve) dhe ndahet nga Xhemati, ai vdes me një vdekje të Xhahilijetit. Dhe kush vdes nën flamurin e një partie apo grupacioni, duke thirrur për partitë apo grupacionet, urren për hir të grupacionit të tij dhe do që të fitojë grupacioni i tij dhe pastaj vritet, atëherë ai është vrarë në gjendje Xhahilijeti. Dhe kush rebelohet kundër Umetit tim duke goditur njerëzit e mirë dhe gjynahqarët e këtij Umeti, atëherë ai (që e bën këtë) s’ka të bëjë fare me mua dhe unë s’kam të bëj fare me atë.”

Pra, i Dërguari i Allahut - ‘*alejhis-salatu ues-selam* - e ka distancuar veten e tij nga ata që ndjekin këtë rrugë.

Ky fanatizëm është i pranishëm, duket qartazi dhe është i prekshëm. Sot nuk pranohen as faktet e as argumentet; ai që thotë të vërtetën po përgënjeshtrohet ndërsa gënjeshtari po besohet. Kjo po ndodh sot.

O vëllezër, ne duhet të qëndrojmë larg këtyre fanatizmave, duhet të mundohemi të çlirohemi nga ato dhe t’i çrrënjoshim nga ky Umet.

I Dërguari fisnik - ‘*alejhis-salatu ues-selam* - ka thënë:

من نصر باطلا وهو يعلمه فلن يزال في سخط الله حتى ينزع،  
ومن قال في مؤمن ما ليس فيه أسكنه الله ردغة الخبال حتى يخرج مما قال.

“Kush ndihmon dhe përkrah të pavërtetën duke e ditur atë, vazhdon që të jenë nën Zemërimin e Allahut derisa ta braktisë atë. Dhe kush thotë për Muslimanin diçka që ai nuk e ka, do të banojë në “Radgatul-Khabaal” derisa t’i tërheqë mbraça ato që ka thënë.”<sup>6</sup>

ردغة الخبال “Radgatul-Khabaal” janë qelbësirat që dalin nga banorët e Zjarrit. Unë mendoj se ky është nga vendet më të këqija në Xhehenem. Allahu na ruajt! Mendoj se ai është vendi më i fëlliqtë dhe më i qelbur ku mund të banojë ai që ndihmon të pavërtetën, qoftë kjo e pavërtetë kufër, qoftë bidat apo çfarëdolloj pavërtetësie qoftë, ndërkohë që ai e di se po përkrah diçka që është e pavërtetë. Ai do të jetë nën Zemërimin e Allahut - ‘*Azxe ue Xhel-le* - derisa ta lerë atë që ka thënë.

---

<sup>6</sup> Hadith Sahih, transmetuar nga Ebu Davudi në Sunenin e tij (n. 3597).

Dhe nëse ai debaton për të mbrojtur të pavërtetën dhe i mvësh Muslimanit gjëra të cilat ai nuk i ka, atëherë Allahu do ta dënojë atë duke e lënë të banojë në qelbësitat që rrjedhin nga njerëzit që dënohen në Zjarrin e Xhehenemit - derisa ai të tërheqë mbrapa ato që ka thënë. Kurse në transmetimin e Taberanit qëndron: “...ai nuk do të dalë prej aty dhe as nuk kanë për ta nxjerrë.” E si mund ta nxjerrin atë kur ai ka bërë akuzë të rreme dhe ka shpifur kundër Muslimanëve të pafajshëm!

Prandaj, vëllezër, e kemi detyrë që të kapemi fort te Litari i Allahut dhe të qëndrojmë larg ndarjes dhe shkaqeve që të shpien në të. Unë lus Allahun - *Tebarake ue Te'ala* - që të na bëjë nga ata që e shohin të vërtetën si të vërtetë dhe të na bëjë të mundur pasimin e saj; si dhe të na bëjë nga ata që e shohin të pavërtetën si të pavërtetë dhe të na bëjë të mundur distancimin nga ajo.

Unë i lutem Atij që të na bëjë thirrësa për tek e vërteta dhe përkrahës të së vërtetës, nga ata që janë larg përkrahjes së të pavërtetës dhe larg atyre që shpifin dhe bëjnë akuza të rreme kundër Besimtarëve të pafajshëm, për të cilët i Dërguari i Allahut na ka njoftuar se çfarë përfundimi të tmerrshëm i pret.

Së fundi, po e mbyll këtë fjalim të përmbledhur duke çuar salavate mbi Pejgamberin fisnik - *'alejhis-salatu ues-selam* - dhe duke ju bërë thirrje sërish që të jeni të bindur dhe ta pasoni atë. Shpresoj se Shejkhu ynë do të na ofrojë komentet e tij, të cilat ai i shikon si të dobishme për bijtë e tij. Lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi Muhamedin, si dhe mbi Familjen e tij dhe Shokët e tij.



## Shtojcë nga Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Ibën Baz

Allahu ju forcoftë!

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirëshëm, Mëshirëplotit. Të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi Familjen e tij, Shokët e tij dhe të gjithë ata që ndjekin udhëzimin e tij.

E më tej:

Dëgjuam këto fjalë të bekuara e të mira nga i nderuari Shejkh Rabij’ Ibën Hadij el-Medkhalij, me temë “**Të kapurit fort pas Librit të Allahut dhe Sunetit dhe paralajmërim kundër çdo gjëje që kundërshton këto të dyja, si dhe kundër shkaqeve të ndarjes, përçarjes dhe pasimin e epsheve me fanatizëm.**” Dhe me të vërtetë ai ka bërë shumë mirë, foli qartë dhe na bëri dobi, Allahu ia shpërbleftë me të mira dhe e shumëfishoftë shpërblimin e tij.

Dhe pikërisht kjo është detyra: të gjykohet në bazë të këtyre të dyjave në çdo çështje të vogël apo të madhe, siç ka thënë Allahu - *Xhel-le ue ‘Alaa* :-

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِيَ الْأَمْرِ مِنْكُمْ ط فَإِن تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِن كُنتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۚ ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ

تَأْوِيلًا ﴿٥٩﴾

“O besimtarë. Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, atëherë drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kijametit. Kjo është për ju është më e mirë dhe më e përshtatshme për përcaktimin e fundit.”<sup>7</sup>

Dhe ka thënë Allahu – i pastër është Ai nga çdo e metë:

---

<sup>7</sup> En-Nisaa`, 59.

وَمَا اخْتَلَفْتُمْ فِيهِ مِنْ شَيْءٍ فَحُكْمُهُ إِلَى اللَّهِ

“Për çdo gjë që kundërshtoheni, gjykimi i saj është tek Allahut.”<sup>8</sup>

Dhe thotë Allahu - *Xhelle ue 'Alaa* :-

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا

“Mbahuni fort të gjithë së bashku në litarin e Allahut dhe mos u përçani!”<sup>9</sup>

Pra, çështja është - siç tha ai - se besimtarët e kanë detyrë që të kapen fort mbas Librit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut - *'alejhis-salatu ues-selam* -, të gjykojnë sipas këtyre të djave dhe çdo konflikt që ndodh midis njerëzve ta kthejmë tek këto të dyja.

Dhe çdo çështje për të cilën Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - dëshmojnë se ajo është e vërtetë dhe e saktë, atëherë ajo është e saktë. Dhe çdo çështje për të cilën Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut dëshmojnë se ajo është e pavërtetë, atëherë ajo është e pavërtetë. Dhe kjo është detyra që ka i gjithë Umeti, sepse Allahu e ka urdhëruar këtë gjë dhe e ka bërë obligim për ne. Poashtu, i Dërguari i Allahut - *'alejhis-salatu ues-selam* - ka thënë të njëjtën gjë.

Dhe detyra e dijetarëve, studentëve të dijes dhe të gjithë atyre që janë të ngarkuar me urdhëresat Fetare është që të kapen fort pas Kur'anit dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - dhe të ndjekin Menhexhin e Selefëve, të cilët janë Shokët e të Dërguarit të Allahut - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - dhe ata që ndoqën rrugën e tyre në mirësi e drejtësi, siç ka thënë Allahu - *'Azze ue Xhelle* :-

---

<sup>8</sup> Esh-Shuura, 10.

<sup>9</sup> Aali-Imran, 103.

وَالسَّابِقُونَ الْأَوْلَىٰ أَوْلَىٰ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالنَّاصِرِينَ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ رَّضِيَ  
اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ وَأَعَدَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ذَلِكَ

### الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١٠﴾

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj, ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!”<sup>10</sup>

Ky shpërblim është për Shokët e Pejgamberit - *sallallahu ‘alejhi ue sellem* -, për ata që i pasuan në mirësi dhe për këdo që ndjek rrugën e tyre.

Prandaj, detyra e nxënësve të dijes është që ta kuptojnë këtë, të jenë të drejtë, të thonë të vërtetën, të ndjekin të vërtetën dhe të paralajmërojnë kundër shkaqeve që të çojnë në ndarje, të paralajmërojnë kundër pasimit të epsheve, kundër ndjekjes me verbëri e fanatizëm të filanit apo fistekut, këtij apo atij grupi e kështu me rradhë.

Është obligim pasimi i të vërtetës dhe të kapurit fort pas saj, si dhe duhet paralajmëruar kundër çdo gjëje që kundërshton të vërtetën, edhe nëse atë gjë e ka thënë babai yt, vëllai yt apo kushdoqoftë. Prandaj, ju e keni detyrë që të ndiqni e të kapeni pas të vërtetës; ajo meriton të ndiqet mbi çdo gjë tjetër. Allahu - *Xhel-le ue ‘Alaa* - thotë në Librin e Tij të Mrekullueshëm:

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنفُسِهِمْ

### حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا تَسْلِيمًا ﴿١١﴾

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.”<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Et-Teubeh, 100.

<sup>11</sup> En-Nisaa`, 65.



Allahu - Xhelte ue 'Alaa - ka thënë:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ

رَّحِيمٌ ﴿١٦٦﴾

“Thuaju: Nëse e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’ju falë grynahet.”<sup>12</sup>

Allahu i Përsosur nga çdo e metë ka thënë:

وَمَا آتَاكُمْ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ

الْعِقَابِ ﴿٧٧﴾

“Çfarëdo që ju jep i Dërguari, merreni, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse vërtet Allahu është i Ashpër në ndëshkim.”<sup>13</sup>

I Dërguari i Allahut - sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem - ka thënë:

من اطاعني فقد أطاع الله، ومن عصاني فقد عصى الله.

“Kush më bindet mua i bindet Allahut, kurse ai që nuk më bindet mua nuk i është bindur Allahut.”

Dhe ai - sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem - ka thënë:

كل أمتي يدخلون الجنة إلا من أبي، قيل: يا رسول الله من أبي؟  
قال: من أطاعني دخل الجنة ومن عصاني فقد أبي.

“I gjithë Umeti im ka për të hyrë në Xhenet përveç atyre që refuzojnë.” I thanë: “O i Dërguari i Allahut, kush do të refuzojë (që të hyjë në Xhenet)?” Ai u përgjigj: “Ai që më bindet mua hyn në Xhenet, kurse ai që nuk më bindet, në të vërtetë ka refuzuar.”

<sup>12</sup> Aali-Imran, 31.

<sup>13</sup> El-Hashr, 7.

Andaj është detyrë e dijetarëve që t’u përcjellin njerëzve të vërtetën si dhe të përpiqen t’i bëjnë ata të kuptojnë detyrat që kanë. Edhe studentët e dijes e kanë për detyrë që të marrin për shembull dijetarët, të ndjekin menhexhin e tyre në qartësimin e të vërtetës dhe të kenë kujdes nga polemikat, mosmarrëveshjet dhe ndjekja e epshit.

Poashtu, është detyrë për njerëzit e thjeshtë që të mos bëjnë lëshim tek e vërteta dhe të pyesin dijetarët e tyre, ata të cilët u mësojnë Sunetin, ata të cilët i mësojnë të jenë të palëkundur në Fenë e Allahut, ata që ju thonë të vërtetën. Ata e kanë detyrë që të jenë të palëkundur dhe t’i pyesin dijetarët për çdo problem që hasin, sikurse ka thënë Allahu - ‘Azze ue Xhelte :-

فَسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٤٣﴾

“Andaj pyetni dijetarët e Librit, nëse nuk dini.”<sup>14</sup>

Gjithashtu, është transmetuar nga i Dërguari i Allahut - *sallAllahu ‘alejhi ue sellem* - se ai u tha atyre që dhanë fetva pa patur dije:

أَلَا سَأَلُوا إِذْ لَمْ يَعْلَمُوا إِنَّمَا شَفَاءُ الْعِيِّ السُّؤَالُ.

“Përse nuk pyetët kur nuk dinit? Vërtet, ilaçi i injorancës është pyetja.”

Poashtu, është detyrë e dijetarëve që të përhapin dituri, të përhapin të vërtetën dhe t’ua qartësojnë njerëzve nëpër xhamia, nëpër mexhliet e zakonshme, nëpër radio, gazeta dhe me çdo mjet me të cilin përcillet dituria. Njerëzit kanë nevojë për diturinë “Allahu ka thënë”, “I Dërguari i Allahut ka thënë”, kanë nevojë t’u sqarohet e pavërteta dhe të paralajmërohet kundër saj.

Ajo që përmendi i nderuari Shejkh Rabij’ për davetin e Shejkh Muhamed Ibën ‘Abdul-Uehhabit - Allahu e mëshiroftë - është mëse e vërtetë, ngase Allahu e dalloi këtë vend me këtë davet të bekuar, dhe ai është pikërisht daveti Selefij. Por armiqtë e Allahut e kanë shtrembëruar imazhin e këtij daveti dhe kanë thënë: “Kjo është lëvizja e shpikur e

---

<sup>14</sup> En-Nahl, 43.

Vehabizmit që ka bërë këto e këto gjëra.” Por në të vërtetë, ata (që kanë thënë këto fjalë) janë të devijuar e bidatçij. Ata ose janë injorantë ose janë njerëz që ndjekin verbërisht injorantët.<sup>15</sup>

Pra, ata ose janë injorantë ose janë pasues të verbër të injorantëve, ose janë një kategori e tretë njerëzish të cilët ndonëse kanë dije ndjekin epshet e tyre, duke u rebeluar kështu ndaj Allahut. Këta janë armiqtë e davetit Selefij.

Pra, ai (që flet kundër këtij daveti) është injorant ose dikush që ndjek verbërisht ndonjë injorant ose dikush që ndjek me fanatizëm epshin e tij për të ngrënë ose u bën qejfin njerëzve për të ngrënë e për të pirë dhe për epshin e tij.

Allahu na dhëntë mirëqënie!

Daveti i Shejkh Muhamedit – Allahu pastë mëshirë për të – është daveti Selefij. Ai ndoqi gjurmët e Sahabëve - *radij-Allahu ‘anhum ue erdahum* -, ashtu si i ndoqën me mirësi edhe Shejkhul-Islam Ibën Tejmije, Ibnul-Kajjim, Ibën Kethiri dhe shumë prej Imamëve të tjerë të Islamit.

---

<sup>15</sup> **Shënim i përkthyesit:** Vërtet, një nga metodat që përdorin njerëzit e bidatit në luftimin e Ehli-Sunetit është emërtimi i tyre me llogape dhe epitete përçmuese. Bidatçijtë në kohën e Selefëve sajuan lloj e soj epitetesësh për të shëmtuar imazhin e Imamëve të Sunetit. Të njëjtën traditë e trashëguan bidatçijtë e brezave që erdhën më vonë. Siç e përmend edhe Shejkh Ibën Bazi më lart, kur daveti i Muhamed Ibën ‘Abdul-Uehhabit u përhap në të gjitha tokat Islame, njerëzit e bidatit dhe devijimit i emërtuan thirrësat e Teuhidit dhe Sunetit me termin “Vehabista”. Dhe e njëjta gjë ka ndodhur edhe në kohët moderne: pas dështimit të revolucionit kharixhij të Ikhanëve në Arabinë Saudite si rezultat i qëndresës që bënë dijetarët Selefijnë me në krye dijetarin e madh Muhamed Aman el-Xhami dhe Rabij’ Ibën Hadi el-Medkhalij, bidatçijtë filluan t’i emërtojnë Selefijnët me llogape të ndryshme, si: “Xhamije”, “Medkhalije”, “Rebiofca”, Rebi’ista”, “Pranverista”, “Selefistët Modern”, “Murrxhiat e Mbretërve”, “Khauarixhët e Davetçijve” etj... Mirëpo fatkeqësia më e madhe është fakti që këta bidatçij fshihen mbas emrit të Shejkh Ibën Bazit - *rahimehullah* - dhe pretendojnë se ndjekin rrugën e tij të moderuar!!! Në të vërtetë, Shejkh Ibn Bazi *rahimehullah* - është i pastër nga pretendimet e tyre të rreme. Ai ka thënë për këta dy dijetarë që janë simbole të Selefizmit në këtë kohë: “Vërtet, Shejkh Rabij’ dhe Shejkh Muhamed Aman el-Xhamij janë Dijetarë të Sunetit. Unë i njoh ata për diturinë dhe mirësinë e tyre.” [Shkëputur nga kasete me titull: *el-Es’iletu es-Suejdijeh*]

Më pas erdhi Shejkh Muhamed Ibën ‘Abdul-Uehhab në shekullin e dymbëdhjetë Hixhrij, gjatë gjysmës së dytë të atij shekulli - Allahu pastë mëshirë për të - tek ky Umet, tek ky Gadishull dhe u sqaroi atyre adhurimin Sheriatik të cilin e ka bërë detyrë Allahu, u sqaroi realitetin e Teuhidit, u sqaroi atë çfarë kishin ndjekur Mushrikët dhe atë çfarë kishin ndjekur Selefët e Umetit, u sqaroi rrugën e Selefus-Salih, i thirri për Xhihad, shkroi libra për të sqaruar të vërtetën, si “*Kitab et-Teuhid*”, “*Keshfush-Shubuhät*”, “*Thelathetul-Usul*”... të cilët janë libra madhështorë dhe mjaft të dobishëm, e kështu me rradhë.

Mes tyre u përhapën librat e Shejkhul-Islam Ibën Tejmijes pasi në to kishte mirësi, dituri dhe ato thërrisnin në Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut - ‘*alejhis-salatu ues-selam* -. Kështu, Allahu u dha dobi Muslimanëve me këtë davet dhe i bashkoi njerëzit e këtij Gadishulli [Arabik] nëpërmjet përkrahësve nga familja Saud dhe njerëz të tjerë që përkrahën të vërtetën dhe ishin të palëkundur tek e vërteta.

Ata i thirrën njerëzit tek Allahu dhe e ndihmuan këtë davet, e ndihmuan Fenë e Allahut dhe ndihmuan Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut - ‘*alejhis-salatu ues-selam* - derisa Allahu i ndihmoi ata dhe u dha fitore ushtarake dhe nëpërmjet tyre i bashkoi njerëzit e gadishullit nga lindja në perëndim, nga veriu në jug, u bashkuan tek e vërteta, duke ndjekur Sheriatin e Allahut dhe duke qenë të palëkundur në praktikimin e fesë së Allahut. Dhe lavdet i takojnë vetëm Allahut.

Kështu pra, detyra është të kapurit fort pas kësaj Akideje dhe pas këtij daveti, t’i ftojme të tjerët tek ajo, ta ruajmë e ta mbrojmë, ta përhapim mes njerëzve me urtësi, me moral të mirë, me butësi dhe jo me ashpërsi dhe vrazhdësi, të sqarohen gabimet, devijimet dhe dyshimet, me sqarim të qartë e me butësi dhe urtësi, e jo me ashpërsi, vrazhdësi dhe sjellje të pahijshme, por duke bërë një shpjegim të qartë, me sjellje të qarta dhe me butësi dhe urtësi, siç thotë Allahu - *Xhel-le ue ‘Alaa* -:

أَدْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمَةِ

“Thirr në Rrugën e Zotit tënd me Urtësi...”<sup>16</sup>

---

<sup>16</sup> En-Nahl, 125.

Kjo do të thotë, thirr me dije, “Allahu thotë”, “I Dërguari i Allahut thotë” dhe duke i vendosur gjëra në vendin ku duhet.

وَالْمَوْعِظَةُ الْحَسَنَةُ وَجَدِلْهُمْ بِأَلَّتِي هِيَ أَحْسَنُ

“...dhe me këshillë të ndershme dhe të bukur dhe bisedo me ta në mënyrën më të mirë.”<sup>17</sup>

Ashtu siç ka thënë edhe i Dërguari - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* -:

ما كان الرفق لا يكون في شيء إلا زانه ولا ينزع من شيء إلا شانه.

“Çdo gjë në të cilën përdoret butësia zbukurohet prej saj; dhe nuk largohet butësia nga ndonjë gjë përveçse shëmtohet.”

Allahu e ka përshkruar të Dërguarin e Tij me thënien e Tij - *SubhaneHu ue Te’ala* -:

فَبِمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَأَنْفَضُوا مِنْ حَوْلِكَ

“Dhe falë mëshirës së Allahut ti u solle butësisht me ta. Por sikur të ishe treguar i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të ishin larguar nga ty.”<sup>18</sup>

Andaj detyra e thirrësave është që t’i kushtojnë rëndësi kësaj, të jenë të mençur dhe të sillen me butësi, të jenë të kujdesshëm dhe me sjellje të qarta e konkrete, të paralajmërojnë kundër vrazhdësisë dhe ashpërsisë dhe të mos jenë fanatikë për filanin apo fistekun.

Lusim Allahun të na japë sukses të gjithëve me dije të dobishme dhe vepra të mira, ta përmirësojë gjendjen e të gjithë Muslimanëve, t’u japë atyre kuptimin e Fesë, të vendosë në krye të tyre njerëzit më të mirë dhe t’u japë sukses udhëheqësve të kësaj Mbretërie.

Lusim Allahun që t’u japë sukses udhëheqësve tanë duke i udhëzuar tek çdo e mirë dhe t’i japë ngadhënjim të vërtetës nëpërmjet tyre, t’i bëjë ata

<sup>17</sup> En-Nahl, 125.

<sup>18</sup> Aali-Imran, 159.

udhëzues prej të udhëzuarve, t'i udhëzojë ata që janë pranë udhëheqësve dhe që t'i ruajë nga miqtë dhe këshilltarët e këqinj.

Gjithashtu, unë i lutem Allahut që t'i japë sukses të nderuarit Shejkh Rabij' në çdo të mirë dhe ta shpërblejë atë me të mira për ligjëratën e mbajtur.

Lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë për Pejgamberin tonë, Muhamedin, për Familjen e Tij, Shokët tij dhe për të gjithë ata që ndjekin rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit.

